

VENDIM
Nr. 15, datë 16.2.2016

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SHPK, NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHTIKA”**

Në mbështetje të neneve 16; 37, germa “a”; dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.2.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Përparimi SK” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrotjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shtika” të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1300 kw,

konstatoi se:

- Aplikimi i shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhëna specifike për HEC-in (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) janë plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjitha sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shtika” me fuqi totale 1300 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti